

## TERMAT E REFERENCËS

Instituti i Studimeve Politike (ISP) kërkon të kontraktojë **një ekspert të jashtëm për propozimin dhe adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve**, pjesë e projektit “Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023”, që ISP do të implementojë me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri me të cilën ISP ka nënshkruar një kontratë granti.

<b>Pozicioni / Shërbim</b>	Ekspert për propozimin dhe adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve
<b>Titulli i Projektit</b>	“Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023”
<b>“Mbështetur:</b>	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri
<b>Lloji i Kontratës :</b>	Kontratë shërbimi
<b>Periodha e kontratës</b>	Nëntor 2021 - Mars 2023
<b>Koha e punës</b>	24 ditë

### Rreth ISP-së

ISP është organizatë joqeveritare në fushën e studimeve politike në Shqipëri. Fokusi i saj kryesor është monitorimi i proceseve politike të tranzicionit, aktivitetit të institucioneve politike dhe kushtetuese, edukimi publik përmes parimeve të transparencës, pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe njohjes së koncepteve thelbësore për demokraci funksionale.

Prej vitit 2016 Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke monitoruar parlamentin dhe aktivitetin parlamentar. ISP ka kryer monitorimin periodik klasik të parlamentit përmes mbështetjes së FES (2016-2017), përmes mbështetjes nga ambasada e Hollandës (2017-2020). ISP ka monitoruar gjendjen e konfliktit të interesit në parlament dhe jetësimin e Kodit të Sjelljes

me mbështetjen e ambasadës së Norvegjisë (2019-2020), aktivitetin parlamentar në periudhën e COVID me mbështetjen e NDI, Dekriminalizimin në politikë dhe në jetën parlamentare 2019-2021 me mbështetjen e ambasadës holandeze dhe tashmë nga 2021-2023 me mbështetjen e NED, mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë 2019-2022 me mbështetjen e CESS, monitorimin e progresit të Shqipërisë në drejtim të integritetit, me fokus parlamentin 2019-2022 me mbështetjen e KAS, etj.

## **Rreth projektit**

Projekti aktual i monitorimit të parlamentit dhe aktivitetit parlamentar jetësohet me mbështetjen e ambasadës Zvicerane në Shqipëri dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri. Ky projekt synon, Monitorimin e Kuvendit për të mundësuar transparencë dhe llogaridhënie përmes vlerësimit të programit të transparencës në Kuvend dhe efikasitetit të veprimtarisë së deputetëve dhe grupeve parlamentare në lidhje me detyrimet kushtetuese, aktet rregullatorë ligjore dhe të brendshme parlamentare. Qëllimi kryesor është ndikimi pozitiv në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe aktivitetit përfaqësues të Kuvendit dhe deputetëve. Monitorimi aktiv i Kuvendit dhe aktiviteti i deputetëve është i favorshëm për krijimin e një sistemi të vlerësimit publik

## **Qëllimi i shërbimit**

Kërkohe bashkëpunimi me një *ekspert të jashtëm për propozimin dhe adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve mbi aktivitetin parlamentar 2021-2023*. Eksperti është përgjegjës për monitorimin dhe adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore, bashkërendon punën me ekspertët e tjerë monitorues dhe ligjorë të projektit si dhe për përgjegjësi të tjera të poshtëshënuara të detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit.

## **Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm**

### **Profili i ekspertit:**

- Të paktën dy vjet përvojë profesionale përkatëse në një funksion të ngjashëm në kontekstin kombëtar apo ndërkombëtar – dialog publik, advokim dhe komunikim
- Përvojë kërkimore (desk research) dhe adresim rekomandimesh;
- Aftësi të shkëlqyera hulumtuese;
- Shumë i/e organizuar në nivel detyre dhe projekti;

### **Edukim/Eksperiencë Profesionale/Gjuhë të huaja:**

- Diplomë universitare për Shkenca Juridike, Politike, Filologjike apo Mediatike ;
- Minimum 3 vjet eksperiencë profesionale në fushën përkatëse;
- Eksperienca në fushën e OjF-ve, ose monitorime dhe rekomandime institucioneve do të konsiderohet një aset

## **Aftësitë individuale**

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi analitike dhe mendim kritik;
3. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afateve të vendosura;
4. Të ketë aftësi të punojë nën presionin e kohës;

## **Detyra dhe përgjegjësitë**

Eksperti i përzgjedhur për këtë pozicion duhet të bashkëpunojë ngushtazi me Drejtuesin e projektit, Koordinatorin dhe ekspertët e përfshirë në projekt për këshillimin e materialeve të dërguara, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Puna e Ekspertit Ligjor konsiston në:

- Shprehjen e opinionëve dhe rekomandime lidhur me nismat e ndryshme ligjore;
- Gjetje mbi monitorimin e akteve të plota zyrtare të miratuara në Kuvend;
- Ofrimin e angazhimit profesional në bashkëpunim me stafin e ISP për sugjerime, nisma të përbashkëta, harmonizim rekomandimesh, etj;
- Asistimin në vëzhgimin dhe adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve nëpërmjet ISP tek autoritetet përgjegjëse, tek partitë parlamentare, në parlament, etj;
- Hartimin e propozimeve duke adresuar gjetjet nga monitorimi, reflektimin e sugjerimeve dhe kërkesave të ISP, në variantin përfundimtar të dokumentit/raportit;
- Gjetje apo rekomandime lidhur me kornizën ligjore, rastet e paqartësive apo ndërhyrjeve për përmirësim, lidhur me rastet e seancave dëgjimore ku ftohet ISP për nisma ligjore në Kuvend, etj ;
- Bën gjetjet kryesore të vlerësimit dhe rekomandimet duke u mbështetur në gjetjet e vlerësimit në mënyrë që të përmirësohet rezultati i zbatimit të ligjit;
- Dorëzimin e timesheet-eve përkatëse në fund të çdo muaji;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e ofruar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

## **Procedura e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e eksperti ligjor duhet të dërgojnë me email:

1. Letër motivimi;
2. Curriculum Vitae
3. Oferta financiare ( të gjitha taksat përfshirë);
4. Punë ngjashme të realizuara më parë nga kandidati;
5. Kopje ID/Pasaportë;

## Procedura e Vlerësimit

Kualifikimet dhe eksperiencia juaj duhet të jenë konform kërkesave të specifikuara në Termat e Referencës. CV juaj do të vlerësohet për përputhjen e eksperiencës dhe kualifikimeve tuaja me kriteret e vendosura dhe që lidhen me:

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në përqindje
(i) Kualifikime të përgjithshme/ Eksperiencat e mëparshme	30 pikë
(ii) Përshtatshmëria me ToR në projekt;	40 pikë
(iii) Ofertë Financiare	30 pikë

REZULTATI TOTAL 100 pikë

## Kostot dhe Pagesat

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë 360,000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë bruto në total. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas paraqitjes së materialeve të realizuara nga eksperti për punën e kryer. Dërgimi i materialit për rekomandime bëhet në varësi të gjetjeve dhe analizave lidhur me veprimtarinë parlamentare.

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 30/10/2021 ora 12:00:

- në formë elektronike në adresën e e-mailit [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com),
- me postë në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë/ ose dorazi me zarf të mbyllur pranë zyrave të ISP me titullin e projektit Monitorimi i parlamentit-referencë-Ekspert ligjor.

Të gjithë aplikuesit fitues apo jo fitues do të lajmërohen pas procedurës së përzgjedhjes, prandaj lutemi specifikoni qartë adresën e subjektit, e-mail ose një nr. kontakti.

## Instituti i Studimeve Politike

Projekt i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.